

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Kontabilisti në Biznes  
Accountant in Business

**P3**

**Zgjidhjet**

Data 10.10.2020

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga <del>ShKCAK-</del> <b>PIKËT E DHËNA</b>
1. Detyra 1	20	
2. Detyra 2	20	
3. Detyra 3	20	
4. Detyra 4	20	
5. Detyra 5	20	
<b>Total</b>	100	

## Problemi 1

Krizat e shpeshta ekonomike nëpër shtete të ndryshme të botës, përfshirë edhe vendet ekonomikisht të zhvilluara shumë shpesh ndikojnë në rënien e performancës financiare të kompanive e me këtë edhe të ndikojë në shkurtimin e shpenzimeve të shumta, përfshirë këtu edhe shkurtimin e shumë vendeve të punës. Shkurtimet e tilla rrisin më tej papunësinë nëpër shtetet të cilat preken nga efektet e krizave, duke sjellë rrjedhimisht edhe pasoja të shumta. Qeveritë e këtyre shteteve planifikojnë dhe ndërmarrin një sërë hapash për të zbutur efektet e krizave si dhe për të krijuar vende pune duke reduktuar kështu papunësinë.

### Kërkesat e detyrës:

- 1) Çfarë janë hyrjet në masën e të papunëve? (5 pikë)
- 2) Cilat janë mundësitë që mund të provohen nga ana e Qeverisë për të krijuar vende pune ose për të reduktuar papunësinë? (10 pikë)
- 3) Cilat janë pasojat e papunësisë? (5 pikë)

**(Totali 20 pikë)**

## Zgjidhja

1)

(a)

- Anëtarët e fuqisë punëtore që bëhen të papunë
- Nxjerrjet nga puna
- Dorëheqjet vullnetare nga puna
- Shkurtime të vendeve të punës

(b)

- Njerëzit që vijnë nga fuqia punëtore dhe që i bashkohen të papunëve
- Ata që lënë/mbarojnë shkollën e që nuk kanë një punë
- Të tjerët (për shembull, nënat me fëmijë) që tani fillojnë të kërkojnë punë por që nuk kanë ende një të tillë

2)

Mundësitë që janë në dispozicion të qeverisë për të krijuar vende të punës ose për të reduktuar papunësinë.

- a) Duke shpenzuar më shumë para drejt për së drejti për punët (për shembull duke marrë në punë më shumë persona në administratën shtetërore)
- b) Duke inkurajuar rritjen në sektorët ekonomisë private. Gjatë kohës kur kërkesa agregate rritet, firmat me mundësi të madhe do të dëshirojnë të rrisin prodhimin e produkteve në mënyrë që të përmbushen kërkesat, dhe duke marrë më shumë njerëz në punë në këtë mënyrë.
- c) Duke inkurajuar trajnimin dhe aftësimin në punë. Mund të ketë një nivel të lartë të papunësisë për punonjësit që nuk kanë aftësitë e duhura, dhe në të njëjtën kohë oferta e punës së kualifikuar mund të jetë e pamjaftueshme. Qeveria mund të ndihmojë me financimin e skemave të trajnimit, në mënyrë që të ofrojë një 'masë' të punonjësve që kanë aftësitë për të cilat kanë nevojë firmat e për të cilat më vonë do të paguajnë.
- d) Duke ofruar asistencë në formën e granteve ndaj punëdhënësve në zona kyçe rajonale
- e) Duke inkurajuar lirshmërinë e lëvizjes së krahut të punës nëpërmjet ofrimit të ndihmës financiare ndaj individëve për të përballuar shpenzimet, dhe për të përmirësuar rrjedhjen e informacioneve për vendet e lira të punës

Ka edhe politika të tjera të drejt për drejta për reduktimin e pagave reale në nivelin që ofron tregu.

- a) Duke ofruar marrëveshje të mbyllura, të cilat e kufizojnë anëtarësimin e personave të punësuar në punë të caktuara në bashkimet profesionale
- b) Duke ndaluar rregulloret e pagave minimale, nëse ka rregullore të tilla

3)

Papunësia rezulton në problemet e mëposhtme.

- a) Humbja e prodhimit. Në qoftë se njerëzit nuk punojnë, ekonomia nuk prodhon aq produkte sa mund të kishte prodhuar. Në këtë mënyrë, totali i të ardhurave kombëtare është më i vogël se sa mund të jetë në të vërtetë.
- b) Humbja e kapitalit njerëzor. Në qoftë se ka papunësi, të papunët gradualisht do të humbin aftësitë e tyre, për arsye se aftësitë mund të ruhen vetëm duke punuar.
- c) Rritja e pabarazisë në distribuimin e të ardhurave. Njerëzit e papunë fitojnë kompensime më të vogla se sa njerëzit e punësuar, dhe në këtë mënyrë kur papunësia rritet, të varfrit bëhen edhe më të varfër.
- d) Kostot sociale. Papunësia sjell me vete probleme sociale të tilla si vuajtjet personale dhe stresi, dhe me mundësi të madhe, në të njëjtën kohë edhe rritjen e krimeve të tilla si vjedhjet dhe vandalizmi.
- e) Rritja e barrës së pagesave të asistencës sociale. Diçka e tillë mund të ketë një ndikim kryesor mbi politikat fiskale të qeverisë.

## **Problemi 2**

Gjatë viteve të fundit, frika se tërësia e informacioneve që mbajnë organizatat rreth individëve mund të keqpërdoret është bërë përherë e më e madhe.

Në veçanti, ndihej se individët mund të dëmtoheshin lehtësisht për shkak të të dhënave të kompjuterizuara rreth tij, të cilat mund të ishin të pasakta ose çorientuese dhe të cilat mund të transferoheshin ndaj palëve të treta të paautorizuara shumë shpejt dhe pothuajse pa asnjë kosto.

Literatura e lëndës P3 - Kontabilisti në Biznes cek se në Mbretërinë e Bashkuar legjislacioni aktual që mbulon këtë çështje është Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave i vitit 1998. Republika e Kosovës ka poashtu një ligj për Mbrojtjen e të Dhënave.

### **Kërkesat e detyrës:**

- 1) Çfarë janë të dhënat personale? (5 pikë)
- 2) Çfarë është fshehtësia (privacia)? (10 pikë)
- 3) Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave në Mbretërinë e Bashkuar përfshin tetë Parimet për Mbrojtjen e të Dhënave të cilat duhet të zbatohen nga përdoruesit e të dhënave. Përmendni dhe sqaroni së paku dy prej këtyre parimeve. (5 pikë)

**(Totali 20 pikë)**

### **Zgjidhja**

## Zgjidhja

- 1) Të dhënat personale janë informacione rreth një jetës së një individi, përfshirë shprehjet e opinioneve rreth tij ose saj. Të dhënat rreth organizatave nuk janë të dhëna personale.
- 2) Fshehtësia (privacia) është e drejta e individëve që të kontrollojnë përdorimin e informacioneve rreth vetes së tyre, përfshirë informacionet mbi statusin financiar, shëndetin dhe mënyrën e jetesës (pra parandalimi i qasjes së paautorizuar ndaj të dhënave të tyre).
- 3)

### PARIMET E MBROJTJES SË TË DHËNAVE

Aneksi 1 i Ligjit përmban parimet e mbrojtjes së të dhënave.

- 1 Të dhënat personale duhet të përpunohen drejtë dhe sipas ligjit dhe, në veçanti, nuk do të përpunohen me përjashtim të rasteve kur:
  - (a) Përmбуshet të paktën një nga kushtet në Aneksin 2 (shikoni paragrafin 5.5.3 (c) në këtë kapitull).
  - (b) Në rast se të dhënat personale kanë karakter të ndjeshëm, përmбуshet të paktën një nga kushtet në Aneksin 3 (shikoni 4.5.3 (d)).
- 2 Të dhënat personale duhet të përftohesh vetëm për një ose më shumë qëllime specifike dhe të ligjshme, dhe nuk duhet të përpunohen më tej në mënyra që nuk janë në përputhje me atë qëllim ose këto qëllime.
- 3 Të dhënat personale duhet të jenë të përshtatshme, relevante dhe jo të tepruara për sa i takon qëllimit ose qëllimeve për të cilat ato po përpunohen.
- 4 Të dhënat personale duhet të jenë të sakta dhe, sa herë që është e domosdoshme, të azhurnohen.
- 5 Të dhënat personale që përpunohen për ndonjë qëllim ose qëllime të caktuar nuk duhet të mbahen më gjatë se sa është e domosdoshme për atë qëllim ose qëllime.
- 6 Të dhënat personale duhet të përpunohen në përputhje me të drejtat e subjektit të të dhënave sipas këtij Ligji.
- 7 Duhet të merren teknikat dhe masat e duhura organizative kundër përpunimit të paautorizuar ose të paligjshëm të të dhënave personale dhe kundër humbjes ose shkatërrimit të tij aksidental, ose dëmtimit të të dhënave personale.
- 8 Të dhënat personale nuk duhet të transferohen në vende ose territore jashtë Zonës Evropiane Ekonomike me përjashtim të rasteve kur vendi ose territori tjetër bën të sigurt se ka një nivel të përshtatshëm të mbrojtjes së të drejtave dhe të lirive të subjektit të të dhënave për sa i takon përpunimit të të dhënave personale.

### Problemi 3

Kontraktimi i palëve të jashtme u popullarizua në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në fund të shekullit 21. Definicioni i kontraktimit të palëve të jashtme mund të nënkuptojë kontraktimi brenda vendit por edhe jashtë vendit. Njëri ndër faktorët kryesorë që nxit kompanitë e ndryshme të kontaktojnë palët e jashtme është kursimi financiar, meqë eliminon kërkesën për shpenzime të vazhdueshme për shërbime të caktuara për të cilat kompania mund të mos ketë nevojë të përhershme, por duke i mundësuar asaj në të njëjtën kohë që të njëjtat shërbime të mund t'i shfrytëzojë në momentin kur paraqitet nevoja për to e të cilat do të ofrohen nga ana e kontraktorëve të jashtëm. Disa prej përparësitë e kontraktimit të palëve të jashtme përfshijnë por nuk kufizohen vetëm në të mëposhtmet: fleksibiliteti në caktimin e stafit, mospërqendrimi në aspekte në të cilat kompania nuk specializon, rritja e kontrollit operacional në fushat e specializimit të kompanisë, reduktimi i shpenzimeve të caktuara administrative, etj. Për këto dhe përparësitë e tjera, është gjithnjë e më i madh numri i kompanive të cilat orientohen për këtë lloj procesi.

#### Kërkesat e detyrës:

- 1) Çfarë është kontraktimi i palëve të jashtme? (5 pikë)
- 2) Cekni dhe përshkruani llojet e kontraktimit të palëve të jashtme? (7.5 pikë)
- 3) Cilat janë disa prej pengesave nga kontraktimi i palëve të jashtme? (7.5 pikë)

(Totali 20 pikë)

#### Zgjidhja

## Zgjidhja

- 1) Kontraktimi i palëve të jashtme është dhëni e kontratave për kryerjen e veprimtarive ose shërbimeve specifike ndaj një kontraktori të jashtëm.
- 2) Llojet e kontraktimit të palëve të jashtme:
  - I rastësishëm - Organizata ka një kërkesë afat - shkurtër për sisteme informative ose të teknologjive informative. Një shembull i tillë do të ishte punësimi i programuesve me kontrata afat - shkurtra për të ndihmuar me programimin e një softueri (programi kompjuterik) të bërë më porosi.
  - Menaxhimi i projekteve - Zhvillimi dhe instalimi i një sistemi informativ ose i teknologjive specifike informative jepet me kontratë. Për shembull, një sistem i ri kontabël.
  - I pjesshëm - Disa shërbime për sisteme informative ose të teknologjive informative jepen me kontrata të jashtme. Shembuj të tillë përfshijnë ruajtjen e pajisjeve elektronike, menaxhimi i rrjeteve ose menaxhimi i vazhdueshëm i faqeve të internetit.
  - Total - Një furnitor i jashtëm ofron shumicën dërrmuese të shërbimeve për sisteme informative ose të teknologjive informative; për shembull pala e tretë ka në pronësi ose është përgjegjës për pajisjet, softuerët (programet kompjuterike) dhe personelin e teknologjive informative.
- 3) Disa pengesa të mundshme janë dhënë më poshtë.
  - a) Mund të argumentohet se informacionet dhe ofrimi i tyre është një pjesë e vetvetishme e biznesit dhe e menaxhimit. Në ndryshim nga pastrimi i zyrave, ose ofrimi i ushqimeve, një nga shërbimet e teknologjive informative të organizatës mund të jenë shumë të rëndësishme për t'u kontraktuar ndaj palëve të jashtme. Informacionet janë zemra e menaxhimit.
  - b) Kompania mund të ketë informacione që janë shumë sekret dhe lënia e palëve të jashtme të merren me to mund të shihet si diçka e rrezikshme nga pikëpamja komerciale dhe/ose ligjore.
  - c) Në qoftë se një palë e tretë është duke u marrë me shërbime të teknologjive informative menaxhmenti i brendshëm nuk do të ketë mundësi të azhurnojë veten më zhvillimet e reja ose të sugjerojnë ide të reja. Si pasojë, mund të mos përftohen edhe aq shumë përparësi konkurruese. Teknologjitë ose implementimet e reja që krijohen nga palët e treta me mundësi të madhe do të jenë në dispozicion të konkurrentëve.
  - d) Organizata mund ta ndjejë veten të mbytur nga një kontratë e pakënaqshme. Mund të jetë e vështirë që vendimi të kthehet prapsh. Në qoftë se ofruesi i shërbimeve ofron nivele të pakënaqshme të shërbimeve, organizata do të duhet të shpenzojë përpjekje dhe shpenzime për të rindërtuar funksionin e saj të teknologjive të tilla ose të kalojë tek një ofrues tjetër dhe këto kosto mund të jenë domethënëse.
  - e) Përdorimi i një organizate të jashtme nuk e inkurajon ndërgjegjësimin për sa i

takon kostove dhe përfitimeve të mundshme të teknologjive informative brenda për brenda organizatës. Në qoftë se menaxherët nuk mund të menaxhojnë vetë me efektivitet burimet e teknologjive informative, mund të argumentohet se ata nuk do të jenë të aftë të menaxhojnë me efektivitet as marrëveshjen për kryerjen e punëve.

#### Problemi 4

Në kushtet e një hiper konkurrence me të cilën përballen ndërmarrjet në një ekonomi funksionale tregu, ajo që u mundëson kompanive të mbijetojnë, ruajnë pjesëmarrjen në treg dhe shënojnë norma të kënaqshme profiti, është sigurimi i një përparësie konkurruese, ose më konkretisht ofrimi i produkteve a shërbimeve unike, të cilat karakterizohen nga tipare të fuqishme cilësore dhe të cilat arrihen përmes një sistemi të vlerave. Porter (në *Përparësitë Konkurruese*) i ka grupuar aktivitetet e ndryshme të një organizate në të ashtuquajturin **zinxhiri i vlerave**.

#### Kërkesat e detyrës:

- 1) Cekni dhe përshkruani aktivitetet kryesore të zinxhirit të vlerave. (7 pikë)
- 2) Cekni dhe përshkruani aktivitetet mbështetëse të zinxhirit të vlerave.  
(7 pikë)
- 3) Michael Porter beson se ka tre strategji të përgjithshme për të përfunduar përparësi konkurruese. Përmendni dhe sqaroni së paku dy prej tyre.  
(6 pikë)

**(Totali 20 pikë)**

#### Zgjidhja

1) Aktivitetet kryesore të zinxhirit të vlerave janë:

- 1) Logjistika e drejtuar përbrenda - Marrja në dorëzim, përpunimi dhe ruajtja e lëndëve të para që përdoren në sistemin e prodhimit: magazinat, transporti, kontrolli mbi stoqet e kështu me radhë.
- 2) Veprimtaritë - Konvertimi i lëndëve të para (inputeve) në një produkt përfundimtar. Lëndët e para nuk janë vetëm materialet. Njerëzit janë një burim i vlefshëm sidomos në industrinë e shërbimeve.
- 3) Logjistika e drejtuar jashtë - Ruajtja e produkteve dhe shpërndarja e tyre tek klientët: paketimi, provimi, dorëzimi e kështu me radhë.
- 4) Marketingu dhe shitjet - Informimi i klientëve rreth produkteve, bindja e tyre që ta blejnë atë: reklamat, promovimi e kështu me radhë.
- 5) Shërbimet pas shitjes - Instalimi i produkteve, riparimi i tyre, azhurnimi i tyre, ofrimi i pjesëve të këmbimit e kështu me radhë.

2) Aktivitetet mbështetëse të zinxhirit të vlerave janë:

- 1) Prokurimi - Blerja e burimeve të lëndëve të para për aktivitetet kryesore (për shembull blerja e materialeve, nën-përbërësve, pajisjeve).
- 2) Zhvillimi i teknologjisë - Krijimi i produkteve, përmirësimi i proceseve dhe/ose përdorimi i burimeve.
- 3) Menaxhimi i burimeve njerëzore - Punësimi, trajnimi, zhvillimi dhe shpërblimi i njerëzve.
- 4) Infrastruktura e firmës - Planifikimi, financimi, kontrolli i cilësisë: Porter besonte se është thelbësisht shumë e rëndësishme për aftësitë strategjike të një organizate që të gjitha këto aktivitete kryesore të jenë të pranishme.

3)

- a) Lider sipas kosto më të ulët -nënkupton që jeni kompania që prodhon me koston më të ulët në industri si një e tërë.
- b) Diferencimi është përdorimi i një produkti ose shërbimi të cilin *industria si një e tërë* beson se është unik.
- c) Fokusi përfshin një kufizim të aktiviteteve vetëm me atë pjesë të caktuar të tregut (një segment).
  - Që ofron mallra dhe/ose shërbime me kosto më të ulët (fokusimi në kosto)
  - Që ofron një produkt ose shërbime të ndryshme nga të tjerat (fokusimi në diferencim)

## Problemi 5

Informacionet kontabël përmblihen në pasqyra financiare për të përmbushur **nevojat për informacione** të këtyre grupeve të ndryshme. Dhe normalisht jo të gjitha nevojat do të përmbushen njëtrajtshmërisht.

**Menaxherët** e një biznesi kanë kryesisht nevojë për informacione , të cilat i ndihmojnë ata të marrin vendime për sa i takon kontrollit dhe planifikimit. Është normale që ata të kenë qasje 'të posaçme' ndaj informacioneve rreth biznesit, sepse ata janë në gjendje të kërkojnë çfarëdolloj pasqyre të ndërtuar në atë mënyrë që e kërkojnë vetë ata. Meqenëse menaxherët kanë nevojë për informacione të konsiderueshme rreth kostove dhe fitim- prurjes së produkteve individuale, ose pjesëve të tjera të ndryshme të biznesit të tyre, ata i përftojnë këto informacione nëpërmjet një sistemi i cili ndjek kostot dhe mban kontabilitetin menaxherial.

### Kërkesat e detyrës:

- 1) Sqaroni së paku tre nga përdoruesit e pasqyrave financiare? (7 pikë)
- 2) Sqaroni së paku pesë cilësi të informacioneve relevante? (7 pikë)
- 3) Ku qëndron dallimi midis kontabilitetit financiar dhe kontabilitetit menaxherial? (6 pikë)

**(Totali 20 pikë)**

### Zgjidhja

## Zgjidhja

- 1) Përdoruesit e pasqyrave financiare janë:
  - a) Menaxherët e kompanisë të caktuar nga pronarët e kompanisë për të mbikëqyrur aktivitetet e përditshme të kompanisë. Atyre iu nevojiten informacione rreth situatës financiare të kompanisë – mënyrës se si është tani dhe se si pritet të jetë në të ardhmen. Kjo iu mundëson atyre arritjen e efikasitetit në biznes dhe marrjen e vendimeve efektive.
  - b) Aksionarëve të kompanisë, pra pronarëve të kompanisë, të cilat duan të dinë se sa mirë po përmbushin menaxhmenti detyrat e veta. Ata duan të dinë se sa fitimprurëse janë aktivitetet afariste të kompanisë dhe sa fitim mund të tërheqin prej biznesit për ta përdorur për qëllimet e tyre personale .
  - c) Personat që punojnë me kompaninë përfshijnë furnitorët të cilët furnizojnë kompaninë mallra me kredi (afat pagese) dhe klientët të cilët blejnë mallra ose shërbime të prodhuara nga kompani. Furnitorët kërkojnë të dinë rreth aftësisë së kompanisë për të paguar borxhet e veta; klientët kërkojnë të dinë nëse kompania është një vend i sigurt prej nga furnizohen dhe nëse është ose jo në rrezik të mbyllet.
  - d) Personat që financojnë kompaninë mund të jenë një bankë e cila i lejon kompanisë të ketë një overdraft, ose që i siguron kreditim afatgjatë duke i garantuar një kredi. Banka dëshiron të sigurohet se kompania është e aftë të ri - paguajë pagesat e interesit, dhe bashkë me shumat e marra hua.
  - e) Autoritetet tatimore kërkojnë të dinë rreth fitimeve të biznesit në mënyrë që të vlerësojnë tatimet e pagueshme prej kompanisë, përfshirë këtu Tatimin në Vlerën e Shtuar e tatime të tjera të shitjes.
  - f) Punonjësit e kompanisë duhet të kenë të drejtën e marrjes së informacioneve rreth situatës financiare të kompanisë, për arsye se e ardhmja e tyre, karriera dhe shuma monetare e pagave dhe rrogave të tyre varet prej kësaj situatë.
  - g) Analistët dhe këshilltarët financiarë kanë nevojë për informacione për klientët ose personat që marrin këshilla prej tyre. Për shembull, agjentët e këmbimit të aksioneve kanë nevojë për informacione në mënyrë që të këshillojë personat që duan të investojnë; agjencitë e kreditit duan informacione në mënyrë që të këshillojë furnitorët e mundshëm të mallrave të kompanisë; dhe gazetarët kanë nevojë për informacione për publikun që lexon mediat e tyre.
  - h) Qeveritë dhe agjencitë e tyre janë të interesuara për alokimin e burimeve dhe si pasojë për entitetet e biznesit. Ato gjithashtu kërkojnë informacione në mënyrë që të marrin të dhëna për statistika kombëtare.
  - i) Publiku i gjerë. Entitetet kanë ndikim mbi elementët e publikut të gjerë në një sërë mënyrash. Për shembull, nëpërmjet krijimit të vendeve të punës dhe përdorimit të furnitorëve vendas ato kontribuojnë në ekonominë vendore. Një faktor tjetër i rëndësishëm është efekti i këtij entiteti mbi ambientin, për shembull ndikimi mbi ndotjen.

- 2) Më poshtë janë disa karakteristika që duhet të kenë informacionet kontabël që të jenë të dobishme.
- a) Relevanca [përkatësia]. Informacionet duhet të jenë relevante pra të kenë një përkatësi ose lidhje ndaj qëllimit për të cilin menaxheri kërkon t'i përdorë ato. Në praktikë, shumica e raporteve nuk arrijnë të 'tregojnë atë që duhet të tregojnë' dhe përmbajnë paragrafë jo - përkatës [jo - relevantë] të cilët vetëm sa mërzhisin menaxherët që i lexojnë ato.
  - b) Plotësia. Përdoruesi i informacioneve duhet të ketë të gjitha informacionet që duhet t'i ketë në dispozicion për të kryer siç duhet punën e tij. Nëse përdoruesi nuk ka parasysh një pamje të plotë të situatës, ka shumë mundësi që të marrë vendime të gabuara.
  - c) Saktësia. Informacionet padyshim duhet të jenë të sakta për arsye se përdorimi i informacioneve të gabuara do të kishte pasoja serioze dhe të dëmshme. Megjithatë, informacionet duhet të jenë aq të sakta sa duhen për të përmbushur qëllimin e tyre dhe nuk ka nevojë të tregohen detaje dhe hollësi të panevojshme për hir të saktësisë.
  - d) Qartësia. Informacionet duhet të jenë të qarta për përdoruesin. Në rast se përdoruesi nuk i kupton mirë informacionet në fjalë ai nuk mund t'i përdorë ato ashtu siç duhet. Mungesa e qartësisë është një nga arsyet që komunikimi midis njerëzve bie në nivele të padëshirueshme. Është pra e rëndësishme të zgjidhet mënyra ose kanali i duhur i komunikimit për të bërë të ditura informacionet.
  - e) Besimi. Informacionet duhet të jenë të besueshme për menaxherët të cilët priten t'i përdorin ato. Megjithatë jo të gjitha informacionet janë të sigurta. Disa prej informacioneve duhet të jenë të sigurta, sidomos informacionet që kanë të bëjnë me operacionet, për shembull, ato që kanë të bëjnë me një proces prodhimi. Informacionet strategjike, dhe sidomos ato që kanë të bëjnë me mjedisin janë shpesh të pasigurta. Megjithatë, nëse shprehen qartë supozimet mbi të cilat përpilohen këto informacione, besueshmëria në perceptimin e tyre ka shumë gjasa të jetë më e madhe.
  - f) Komunikimi. Në të gjitha organizatat, individëve iu jepet autoriteti për të përmbushur detyra të caktuara, dhe normalisht që atyre duhet t'u jepen informacionet e duhura për t'i përmbushur ato. Nëse menaxherit të zyrës i është dhënë përgjegjësi për të kontrolluar shpenzimet e zyrës së tij, dhe i është dhënë një buxhet në të cilin paraqiten kufijtë e shpenzimeve për të gjithë vitin, gjatë vitit menaxheri mund të përpiqet t'i mbajë nën kontroll shpenzimet në fjalë, por nëse herë pas here nuk i tregohet se sa është shpenzuar gjithsej deri në datën në fjalë, menaxheri do ta ketë të vështirë dhe mbase dhe të pamundur të gjykojë nëse po e kalon apo jo buxhetin.
  - g) Vëllimi. Kjo ka të bëjë me kufijtë fizikë dhe mendorë të asaj që mund të lexojë, përvetësojë dhe kuptojë mirë një person para se ai të ndërmarrë një veprim të caktuar. Një mal i madh me informacione, edhe sikur të jetë shumë relevant, nuk mund të manovrohet. Raportet që i jepen menaxhmentit duhet të jenë pra, të

qarta dhe koncize (të ngjeshura) dhe në shumicën e sistemeve, ajo që bëhet gjatë redaktimit përfundimtar të raporteve i bindet thjeshtë parimit 'hiqe fare'.

- h) Koha. Informacionet të cilat nuk vihen në dispozicion të përdoruesve para se ata të marrin një vendim do të jetë të dobishme vetëm për qëllime krahasimi dhe për themelimin e kontroleve në afatin e gjatë, duke mos i shërbyer asnjë qëllimi tjetër deri në atë kohë. Edhe informacionet e përgatitura shumë shpesh përbëjnë në vetvete një pengesë të madhe. Në rast se, për shembull, për një aspekt të caktuar të veprimtarive të kompanisë merren vendime në takime që ndodhin vetëm një herë në muaj, atëherë informacionet për marrjen e vendimit do të duhet të kërkohen vetëm një herë në muaj, ndërsa raportet javore do të ishin një humbje e kushtueshme e kohës.
  - i) Mënyrat e komunikimit. Ka raste kur përdorimi i një metode të caktuar të komunikimit është i mirë se sa një tjetër. Për shembull, lajmërimet për punë duhet të komunikohen me anë të një mënyre, e cila do të tërheqë vëmendjen e atyre njerëzve që ka më shumë gjasa të jenë të interesuar. Mënyra të tilla komunikimi mund të jenë cirkularët e brendshëm të kompanisë, gazetatat kombëtare ose lokale, një revistë profesionale, një qendër pune ose zyrat për karierrë në universitete. Memorandumet e brendshme shpërndahen më mirë me 'postë elektronike'. Ka informacione të cilat komunikohen me metoda jo zyrtare nëpërmjet telefonit ose me anë të thashethemeve, ndërsa disa informacione të tjera duhet të komunikohen zyrtarisht me shkrim ose me shifra.
  - j) Kostoja. Informacionet duhet të kenë një vlerë të caktuar, përndryshe nuk do të kishte kuptim të shpenzohet kohë e energji për të mbledhur të dhënat e për t'i përpunuar ato. Përfitimet që mund të përfitohen prej informacioneve duhet në të njëjtën kohë të jenë më të mëdha se kostot e përftimit të informacioneve në fjalë, dhe në rastet kur menaxhmenti provon të vendosë nëse duhet apo nuk duhet të ndërtojë informacione për një qëllim të caktuar (për shembull nëse duhet të kompjuterizojë një operacion apo të ndërtojë një model të planifikimit financiar) duhet të bëhet një studim i kostove/përfitimeve.
- 3) Kontabilitetit financiar është kryesisht një metodë e raportimit të rezultateve dhe pozicionit financiar të një biznesi ndërsa Kontabiliteti menaxherial është një sistem i informacionit për menaxhmentin i cili analizon të dhënat për të përfutur informacione të cilat do të shërbejnë si një bazë për veprimet që do të ndërmarrë menaxhmenti.